



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

RREGULLORE KOMUNALE NR. _____
PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË
SUBVENCIONEVE DHE TRASFEREVE DHE GRANTEVE

Prizren, nëntor 2023

KUVENDI I KOMUNËS

Nr. _____ **dt:** _____

Prizren

Në mbështetje të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2, pika c) dhe nenit 34, paragrafi 34.4 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenin 53 të Ligjit nr. 03-L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: VITI III / nr. 27 / 03 QERSHOR 2008), dhe ndryshim – plotësimin e këtij Ligji, nenin 36 të Rregullit Financiarë 01/2013 – MF – Shpenzimi i Parave Publike, dhe të nenit 21 dhe 27 të Statutit të Komunës së Prizreni, Kuvendi i Komunës së Prizrenit në mbledhjen e mbajtur më _____, miratoi këtë:

RREGULLORE KOMUNALE NR. _____ PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE DHE TRANSFEREVE DHE GRANTEVE

PJESA E PARË DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës së Prizrenit ndarjen e mjeteve financiare pa kthim, nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve për fushat e cekura në këtë rregullore për personat fizik dhe juridik (mbi bazën e kërkesës së tyre dhe thirrjeve publike), dhe ndarjen e granteve, si dhe vendosjen e një sistemi transparent dhe llogaridhënës për financimin dhe subvencionimin e projekteve, aktiviteteve si dhe dhënies së ndihmës për nevoja të ndryshme për persona fizik dhe projekteve apo programeve që realizohen në Komunën e Prizrenit.
2. Komuna ndan subvencione, transfere dhe grante për këto fusha: arsim, kulturë, rini dhe sport, turizëm dhe zhvillim ekonomik, bujqësi dhe zhvillim rural, shëndetësi, rastet sociale, në fushën e mjedisit, fatkeqësitë nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera natyrore, subvencione për radhët e komunitetit jo shumicë, për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut, si dhe duke mos u kufizuar edhe në fusha tjera, si Start-up dhe programe të cilat janë në interes të qytetarëve dhe komunitetit për të cilën është bërë projekti.

3. Ndarja e subvencioneve për OJQ-të që kalojnë shumën e financimit mbi 500 €, bëhet në bazë të Rregullores MF-nr-04/ 2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
4. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga organet komunale gjatë ndarjes së subvencioneve dhe granteve për përfituesit.

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Komuna dhe organet e saj** – ka kuptimin siç është përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.
 - 1.2. **Subvencion** – konsiderohet mbështetja e njëanshme dhe e pakthyeshme me mjete financiare, të cilat mjete barten nga buxheti i Komunës, në llogarinë rrjedhëse të përfituesve me qëllim të realizimit të programeve, projekteve apo aktiviteteve të ndryshme.
 - 1.3. **Transfer** – konsiderohet pagesa e njëanshme, jo të kthyeshme për institucionet joprofitabile, familjet dhe individët.
 - 1.4. **Grant** – konsiderohet ndihma e dhënë nga Komuna, në formën e transferimit të mjeteve financiare apo pajisjeve/mekanizmit tek personi fizik apo juridik, e cila kushtëzohet me qëllim të plotësimit në të ardhmen të kushteve të përcaktuara në Kontratë dhe si kusht që këto mjete/pajisje/mekanizëm t'i përdorin për veprimtaritë që është përzgjedhur.
 - 1.5. **Pagesa e pakthyeshme** - është e njëanshme, atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim ose kundërvlerë për pagesën.
 - 1.6. **Përfituesi** - nënkupton personat fizik dhe juridik që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve, transfereve dhe granteve të planifikuara në Buxhetin e Komunës dhe në pajtim me Ligjin për ndarjet buxhetore.
 - 1.7. **Person juridik** –nënkupton ndërmarrjen (private dhe publike), OJQ, fermerët që operojnë si biznes (agrobizneset) me identitet sipas të dhënave të regjistruara të personave juridik.
 - 1.8. **Person fizik** – nënkupton qytetarin me identitet sipas regjistrave të gjendjes civile të Republikës së Kosovës.
 - 1.9. **Banor rezident** - nënkupton personi që jeton dhe vepron në Komunën e Prizrenit dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.
 - 1.10. **Marrëveshje/Kontratë** – nënkupton dokumentin e nënshkruar ndërmjet Komunës dhe përfituesit, në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.
 - 1.11. **Komision** – nënkupton komisionet të cilat themelohen nga kryetari i Komunës me qëllim të shqyrtimit të kërkesave/projekteve të cilët aplikojnë për subvencione dhe grante.
 - 1.12. **Pagesa direkt** – nënkupton pagesën e dhënë drejtpërdrejtë fermerit për njësi të sipërfaqes, krerë lopë, dele dhe dhi, koshere bletësh dhe litër qumështi.

Neni 3

Kufizimet mbi ndarjen e subvencioneve, transfereve dhe granteve

1. Komuna ndan subvencione dhe transfere, si dhe grante duke u bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin fiskal, për të cilën ndahen subvencionet, transferet dhe grantet, dhe atë vetëm në masën e përcaktuar në këtë ligj.
2. Personat fizik (pa thirrje publike) mund të përfitojnë subvencione dhe transfere sipas dispozitave të kësaj rregulloreje në vlerë maksimale deri në 1.000.00 € (njëmijë euro), përjashtimisht për rastet të cilat subvencionohen nga Drejtoria e Shëndetësi (sipas limit të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 27) dhe Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri (sipas limit të përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 34).
3. Personat fizik dhe juridik të cilët aplikojnë në Thirrje Publike, mund të përfitojnë subvencione dhe grante sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, varësisht nga kostoja e projektit apo programit, për të cilën vendos komisioni përkatës.
4. Projektet apo programet të cilat realizohen me organizata ndërkombëtare dhe vendore të cilat rregullohen me Marrëveshje Bashkëpunimi apo bashkëfinancimi të programeve të caktuara, duhet të respektojnë standardet themelore të financimit, lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin.

Neni 4

Rregullat e përgjithshme të aplikimit për subvencione dhe grante

1. Komuna mund të ndaj subvencione, transfere dhe grante për persona fizik dhe juridik mbi bazën e kërkesës së tyre dhe thirrjeve publike në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe Rregullores MF-nr. 04/ 2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 5

Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencioneve, transfereve dhe granteve

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve nga Komuna mund të zhvillohet mbi bazën e Thirrjes Publike, apo në bazë të kërkesës së arsyetuar, atëherë kur lejohet me dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve përmes thirrjes publike të Komunës përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi.
3. Shqyrtimi i kërkesave për ndarjen e subvencioneve, transfereve dhe granteve në bazë të thirrjes publike bëhet në afat brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga momenti i mbylljes së thirrjes publike për aplikim.

4. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe transfereve jashtë thirrjes publike të Komunës bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës, përjashtimisht Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 6

Përfshirjet nga ndarja e subvencioneve, transfereve dhe granteve

- 1 Përfitues të subvencioneve, transfereve dhe granteve të ndara nga Komuna me thirrje publike nuk mund të jenë përfitues persona fizik apo OJQ, për të cilën projekti nuk realizohet në Komunën e Prizrenit.
- 2 Personi fizik apo juridik vetëm 1 (një) herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve, transfereve dhe granteve të ndara nga Komuna.
- 3 Përfshirje nga paragrafi 2 (dy) i këtij neni bëjnë subvencionet, transferet dhe grantet e ndara për rastet specifike dhe të arsyetuara nga ana e Komisionit, rastet kur nuk ka aplikues të tjerë për projekte të caktuara, dhe subvencionet dhe grantet e ndara në fushën e bujqësisë, apo projektet e financuara përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit.

Neni 7

Thirrja Publike për ndarjen e subvencioneve, transfereve dhe granteve

- 1 Lejimin e thirrjes publike për ndarjen e subvencioneve dhe granteve në kuadër të drejtorisë/njesisë e lejon kryetari i Komunës me Vendim, pas arsyetimit të kërkesës për një thirrje të tillë nga njësia kërkuuese.
- 2 Procesi i ndarjes së subvencioneve dhe granteve fillon përmes thirrjes publike të cilat publikohen në ueb faqen e Komunës ose tabelën e shpalljeve të Komunës.
- 3 Në thirrje përcaktohen qartë kriteret dhe procedurat për të aplikuar ndarjen e subvencioneve dhe granteve të cilat përcaktohen sipas kësaj rregulloreje.
- 4 Thirrja duhet të jetë e hapur së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga data e shpalljes.

Neni 8

Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe granteve të thirrjes publike

- 1 Kryetari i Komunës emëron Komisione të përkohshme në kuadër të secilës drejtori/njësi, të cilët kanë shpallur thirrjen publike për ndarje të subvencioneve dhe granteve për projekte të caktuara, e të cilët janë përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave/projekteve duke u bazuar në kriteret e thirrjes publike, dhe mandati i tij përfundon në momentin e përfundimit të vlerësimit dhe publikimit të vendimit-listës përfundimtare të përfituesve.
- 2 Komisionet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe granteve veprojnë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, dispozitat e kësaj rregulloreje dhe kriteret e thirrjes publike.

- 3 Kryesuesi i Komisionit dhe anëtarët e tij për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe granteve duhet të jenë zyrtar publik. Anëtarë të komisionit vlerësues nuk mund të jenë të emëruarit politik.
- 4 Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe granteve me thirrje publike përbëhet prej 3 deri në 5 anëtarë. Përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore.
- 5 Përveç anëtareve të rregullt nga paragrafi 4, ofruesi i subvencioneve duhet ta parasheh në përbërjen e Komisionit edhe një anëtar (1) rezervë, i cili do të zëvendësoj ndonjërin nga anëtarët e komisionit, të cilët nuk marrin pjesë në vlerësim në rast të mungesës me arsye apo konflikt interesi.
- 6 Projektet apo programet e financuara me marrëveshje bashkëpunimi, nuk kanë komision të veçantë, por caktohet zyrtari monitorues i cili duhet të parashihet në Memorandum të Bashkëpunimit, dhe i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e realizimit të marrëveshjes deri të raportimi (përfundimi i projektit).

Neni 9

Vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarrja për ndarjen e subvencioneve dhe granteve me thirrje publike

- 1 Komisionet bëjnë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, transfereve dhe granteve brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditë pas përfundimit të mbylljes së thirrjes publike.
- 2 Vendimet e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe granteve merren në bazë të pikëve të fituara sipas kriterëve të thirrjes publike.
- 3 Për çdo mbledhje Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe granteve duhet të mbaj procesverbal, i cili duhet të nënshkruhet nga Komisioni.
- 4 Komisionet vlerësuese të cilat veprojnë duke u bazuar në thirrjen publike, pas shqyrtimit të kërkesave/projekteve-planit ideor, duke u bazuar në kriteret e thirrjes publike, marrin Vendim për miratim/refuzim të atyre kërkesave/projekteve, i cili Vendim publikohet në ueb faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve.
- 5 Vendimi përfundimtar i përfituesve të subvencioneve dhe granteve, së bashku me marrëveshjet/kontratat e hartuara nga njësia përkatëse e cila e ka proceduar thirrjen publike, i dorëzohet kryetarit të Komunës me qëllim të lidhjes së kontratës/marrëveshjes me përfituesit.

Neni 10

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve dhe granteve me thirrje publike

- 1 Për secilën drejtori/njësi të cilat kanë shpallur thirrje publike për ndarje të subvencioneve dhe granteve, themelohet Komisioni i ankesave me vendim të kryetarit të Komunës, sipas të cilit përcaktohen mandati, detyrat dhe përgjegjësitë e tij.
- 2 Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve dhe granteve duhet të jenë zyrtar publik.
- 3 Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të subvencioneve dhe granteve me thirrje publike përbëhet prej 3 deri në 5 anëtarë, përbërja e Komisionit duhet të bazohet mbi parimin e barazisë gjinore. Një anëtar i Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve duhet të jetë zyrtar ligjor.
- 4 Përveç anëtarëve të rregullt nga paragrafi 3, ofruesi i subvencioneve duhet ta parasheh në përbërjen e komisionit edhe një anëtar (1) rezervë, i cili do të zëvendësoj ndonjërin prej anëtarëve të komisionit në rast të mungesës me arsye apo konflikt interesi.
- 5 Për çdo mbledhje Komisioni i ankesave duhet të mbaj procesverbal, i cili duhet të nënshkruhet nga Komisioni.
- 6 Anëtarë të Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve, transfereve dhe granteve nuk mund të jenë zyrtarët të cilët kanë qenë pjesë e komisioneve për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve dhe granteve.

Neni 11

Parashtrimi dhe zgjidhja e ankesave

- 1 Ankesa parashtrohet në afat prej 5 (pesë) ditë pune pas publikimit të njoftimit/vendimit të Komisionit vlerësues me vendimin preliminar të përfituesve, përkatësish pas pranimit të vendimit nga pala në rastet kur të njëjtat dërgohen me postë.
- 2 Komisioni duhet të bëjë shqyrtimin e ankesave të cilat parashtrohen nga palët e pakënaqura pas publikimit të vendimit preliminar, dhe të marrë Vendim në afat prej 10 (dhjetë) ditë pune pas paraqitjes së ankesave.
- 3 Me vendimin e Komisionit të ankesave njoftohet parashtruesi i ankesës dhe Komisioni vlerësues.
- 4 Vendimet e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për ndarje të subvencioneve janë përfundimtare në procedurën administrative.

Neni 12
Zbatimi i vendimit/kontratës

1. Vendimi për ndarjen e subvencioneve, transfereve dhe granteve bëhen të zbatueshme nëse:
 - 1.1. nuk është paraqitur ankesë paragrafit 1 të nenit 11;
 - 1.2. me vendimin e Komisionit të ankesave refuzohet ankesa ose në rast të miratimit përfshihet në vendimin përfundimtar.

Neni 13
Marrëveshja/Kontrata për subvencione dhe grante në bazë të thirrjes publike

1. Për realizimin e ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe granteve duhet të lidhet një Marrëveshje/Kontratë me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ndërmjet Komunës dhe përfituesit të subvencionit ose grantit.
2. Marrëveshja/Kontrata duhet të përcaktojë subjektet nënshkruese të saj, qëllimin, shumën e mjeteve financiare, afatet kohore, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, mbikëqyrjen, formën e subvencionimit, raportimin, hyrjen në fuqi, si dhe pjesë tjera relevante për marrëveshjen/kontratën.
3. Nëse me fajin e përfituesit nuk përmbushen obligimet e përcaktuara në Marrëveshje/Kontratë për ndarje të subvencioneve dhe granteve, përfituesi humb të drejtën në përfitim për 3 (tre) vitet e ardhshme nga Komuna e Prizrenit.

Neni 14
SUBVENCIONET DHE TRANSFERET NË ZYRËN E KRYETARIT

1. Kryetari i Komunës sipas kërkesës së arsyetuar të palës, mbështet financiarisht personat fizik, duke u bazuar, por duke mos u kufizuar në këto kritere:
 - 1.1. Për raste të cilët ballafaqohen me varfëri të skajshme;
 - 1.2. Për persona që vuajnë nga ndonjë sëmundje e rëndë dhe për të cilët është një kosto e lartë e mjekimit;
 - 1.3. Për personat fizik të cilët përfaqësojnë Komunën në garë kombëtare dhe ndërkombëtare, si në fushën e shkencës, kulturës, muzikës, rinisë apo sportit.
 - 1.4. Për personat juridik, pas kërkesës, kryetari e vlerëson rëndësinë e programit apo projektit dhe vendos nëse i njëjti duhet të mbështetet përmes marrëveshjes së bashkëpunimit apo bashkëfinancimit, bazuar në pikën 4, të nenit 3.

Neni 15
Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione dhe transfereve në zyrën e Kryetarit përfshijnë, por pa u kufizuar:

- 1.1. Kërkesa e palës;
- 1.2. Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
- 1.3. Konfirmimi i bankës me numrin e xhirollogarisë bankare në emër të përfituesit apo familjarit të tij;
- 1.4. Dëshminë e gjendjes civile që konfirmon lidhjen familjare;
- 1.5. Dëshmia mbi gjendjen ekonomike për rastet e përcaktuara sipas paragrafit 1.1 të nenit 14;
- 1.6. Raportin mjekësor dhe dëshminë mbi koston e mjekimit për rastet e përcaktuar sipas paragrafit 1.2 të nenit 14;
- 1.7. Konfirmimi i pjesëmarrjes së personit fizik në gara për rastet e përcaktuar sipas paragrafit 1.3 të nenit 14.

Neni 16

SUBVENCIONET DHE TRANSFERET E ZYRËS KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

1. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ndan subvencione dhe transfere për persona fizik përmes thirrjes publike duke përfshirë, por duke mos u kufizuar për:
2. Pako ushqimore për raste të cilët ballafaqohen me varfëri;
- 2.3. Lëndë djegëse për dimër.
3. Gjatë ndarjes së subvencioneve dhe transfereve për kategoritë nga pika 1.1 deri në 1.2 të paragrafit 1 të nenit 16, zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim obligohet që pas marrjes së vendimit nga kryetari i Komunës për lejim të mjeteve financiare, të inicioj procedura të Prokurimit në përputhje me projektin/vlerën që do të realizoj.

Neni 17

Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Kushtet, kriteret dhe dokumentet për të qenë përfitues i subvencioneve, transfereve duke u bazuar në kriteret e thirrjes publike, përfshijnë por pa u kufizuar si në vijim:
 - 1.1. Kërkesa e palës;
 - 1.2. Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
 - 1.3. Certifikata e bashkësisë familjare ose L.NJ. për të rriturit dhe ekstraktet e lindjes për të miturit;
 - 1.4. Vërtetim nga zyra e punësimit për të rriturit mbi 18 vjeç;
 - 1.5. Vërtetim se është i punësuar nga punëdhënësi;
 - 1.6. Kartela e pensionit invalidor ose e pensionit me aftësi të kufizuara;

- 1.7. Dëshmi që vërteton se është nënë vetushqyese / baba vetushqyese;
- 1.8. Raport nga mjeku me diagnozë, për të sëmurin në familje.

Neni 18

SUBVENCIONET DHE TRANSFERET NË FUSHËN E ARSIMIT

1. Komuna mund të ndajë subvencione duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:

- 1.1. Bursa për studentë;
- 1.2. Bursa për nxënësit e shkollave të mesme;
- 1.3. Bursa për nxënësit e shkollave fillore;
- 1.4. Bursa për fëmijët me nevoja të veçanta;
- 1.5. Bursa për fëmijët (prindi) raste sociale;
- 1.6. Gara shkollore;
- 1.7. Gara ndërkombëtare me nxënës;
- 1.8. Gara apo kuize (aktivitete jashtë mësimore);
- 1.9. Nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- 1.10. Mësimdhënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 19

Kriteret dhe dokumentet që nevojiten për ndarjen e bursave

1. Kriteret e përgjithshëm për ndarjen e bursave për student nëse:

- 1.1. Nota mesatare mbi 7.5, të cilët kanë fituar të drejtën e regjistrimit të vitit: II-III-IV-V- në vitin akademik në Universitetet Publike të Republikës së Kosovës dhe studentë jashtë shtetit në Universitetet Publike (kriteri i notës mesatare 7.5 nuk vlen për studentët, fëmijë të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe rasteve sociale, ku të njëjtit kanë të drejtë të aplikojnë edhe me notë mesatare më të ultë se 7.5);
- 1.2. Studenti është fëmijë i dëshmorit, invalidit dhe veteranit të luftës;
- 1.3. Studenti është me nevoja të veçanta;
- 1.4. Studentët që nuk i kanë prindërit në jetë;
- 1.5. Kandidatët me gjendje të vështirë ekonomike apo asistencë sociale (kjo vlen vetëm për ata kandidatë, që familja e tyre e gëzojnë të drejtën e asistencës sociale);
- 1.6. Në rast kur në një profil të caktuar nuk ka aplikues /përfitues të bursës, atëherë komisioni i vlerësimit ka të drejtë rialokim të bursave të profilet me prioritet;
- 1.7. Të drejtë konkurrimi për realizimin e bursës kanë studentët - kandidatë që janë banorë të Komunës së Prizrenit.

2. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje e bursave për student përfshinë, por duke mos u kufizuar:

- 2.1. Aplikacioni,
- 2.2. Kopja e letërnjoftimit,

Komentoi [HK1]: Koment I dhënë nga : Milazim Avdylaj. **Te shtohen;**

- Mbështetje: për klubet e nxënësve që veprojnë brenda shkollës por përfaqësohen me aktivitetet jashtë shkolle, si individ apo grup, nivel; komune, regjioni, nivel vendi apo dhe jashtë vendi.
- Promovimi i nxënësve/studentëve talent dhe inovativ;
- Organizimi i trajnimeve, punëtorive, transmetimeve televizive, ligjëratave dhe konferencave që kanë të bëjnë me fushën e arsimit;
- Botimi dhe promovimi i materialeve shkollore si libra, doracakë, modele konkretizuese në mbështetje të ngritjes së cilësisë së nxënësve të nxënësve, zbatim të kurrikulës dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve.
- Prezentime në konferenca dhe aktivitete tjera kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Manifestime: „Dita e shkollës“, „Java ekologjike“, „Dita e vajzave“, „Java e Remzi Ademaj“;
- Vizita studimore për mësimdhënës, student dhe nxënës;
- Shpërblime vjetore: mësimdhënës të

- 2.3. Ekstrakti i lindjes,
- 2.4. Certifikata e vendbanimit,
- 2.5. Kopjen e ID-së së studentit,
- 2.6. Konfirmimin nga banka me numrin e xhirollogarisë së aplikuesit,
- 2.7. Certifikatën e vitit të regjistrimit akademik, duke e cekur.

- a) se është student i vitit të dytë, tretë, katërtin e pestë,
- b) se i ka dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak në afatin e shtatorit – tetorit,
- c) notën mesatare gjatë studimeve të vërtetuar nga fakulteti,
- d) se nuk ka vit të përsëritur gjatë studimeve.

- 2.8. Certifikatën e provimeve të dhëna me datat e dhënies së provimeve;
- 2.9. Vërtetimin se është fëmijë i dëshmorit, invalidit dhe veteranit të luftës, i cili dokument merret në shoqatat e dala nga lufta;
- 2.10. Dëshmi për studentin që aplikojnë për burës që nuk i kanë prindërit në jetë (njërin apo dy prindërit);
- 2.11. Dëshmi mbi gjendjen shëndetësorë (për student më nevoja të veçanta);
- 2.12. Dëshmi se kandidati merr ndihmë sociale të konfirmuar me dokument nga Qendra për Punë dhe Mirëqenie Sociale në Prizren (kjo vlen vetëm për ata kandidatë, që familja e tyre e gëzojnë të drejtën e asistencës sociale).

3. Kriteret e përgjithshëm për ndarjen e bursave për nxënës:

- 3.1. Suksesi i arritur nga nxënësi;
- 3.2. Nxënës në fushat ku ka mungesë të kuadrove;
- 3.3. Për nxënës të familjeve nga kategoritë e dala nga lufta;
- 3.4. Numri i nxënësve në familje (2 e më shumë);
- 3.5. Familja/nxënës me asistencë sociale;
- 3.6. Nxënës me nevoja të veçanta;
- 3.7. Nxënësi që nuk i ka prindërit në jetë.

4. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje e bursave për nxënës, përfshinë, por duke mos u kufizuar:

- 4.1. Aplikacioni;
- 4.2. Certifikata/ekstrakti i lindjes;
- 4.3. Certifikata e vendbanimit;
- 4.4. Konfirmimin nga banka me numrin e xhirollogarisë së aplikuesit (apo prindit);
- 4.5. Certifikata e notave;
- 4.6. Dëshmi së prindërit janë kategori të dala nga lufta;
- 4.7. Dëshmi mbi gjendjen shëndetësore (për nxënësit më nevoja të veçanta);
- 4.8. Dëshmi se numri i nxënësve i të njëjtës familje është 2 e më shumë nxënës;
- 4.9. Dëshmi mbi asistencë sociale (prindi);
- 4.10. Dëshmi për nxënësit që aplikojnë për burës që nuk i kanë prindërit në jetë (njërin apo dy prindërit).

5. Komuna duhet të bëjë shpalljen publike për dhënien e bursave të parapara sipas kësaj Rregulloreje e cila publikohet në ueb faqen e Komunës ose në tabelën e shpalljeve.
6. Subvencionet për rastet nga pika 1.6 deri në 1.10 të paragrafit 1 të nenit 18 të kësaj Rregulloreje, ndahen sipas kërkesave të arsyetuara dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe Rregullores MF-nr-04/ 2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 20

SUBVENCIONET DHE GRANTET NË FUSHËN E TURIZMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

1. Komuna ndan subvencione dhe grante në fushën e turizmit dhe zhvillimit ekonomik për personat fizik dhe juridik në rastet si në vijim, por duke mos u kufizuar:
 - 1.1. Zejet tradicionale;
 - 1.2. Projektet që promovojnë turizmin;
 - 1.3. Grante për biznese fillestare (Start UP);
 - 1.4. Grante dhe subvencione për bizneset ekzistuese;
 - 1.5. Promovim të prodhimeve vendore;
 - 1.6. Aktivitetet e shoqatave të cilat ndihmojnë dhe promovojnë zhvillimin ekonomik dhe turizmin;
 - 1.7. Ndërmarrjet publike lokale.
2. Ndërmarrjet publike lokale mund të subvencionohen duke u bazuar në autorizimet që vijnë nga Ligji vjetor mbi ndarjen buxhetore apo ndonjë Ligj tjetër të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ku subvencionimi do të bëhet në përputhje me dispozitat e atij Ligji dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
3. Kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për përfitimin e subvencioneve dhe granteve për kategoritë nga pika 1.1 deri në 1.6 të paragrafit 1 të nenit 20, caktohen me thirrje publike në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe Rregullores MF-nr-04/ 2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 21

SUBVENCIONET, TRANSFERET DHE GRANTET NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

1. Komuna mund të ndaj subvencione, transfere dhe grante për Bujqësi dhe Zhvillim Rural me thirrje publike duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. Projekte të fermerëve, shoqatave, kooperativat bujqësore në sektorin e bujqësisë me prioritet për komunën;
 - 1.2. Organizimin e panaireve, seminareve, vizitave studimore;
 - 1.3. Mbështetjen e projekteve me bashkëfinancim me donatorët;
 - 1.4. Mbështetjen e projekteve për zhvillim dhe turizëm rural;
 - 1.5. Ndarja e pajisjeve dhe mekanizimit bujqësor;
 - 1.6. Ngritja e serrave;

- 1.7. Projekte në fushën e pemëtarisë;
 - 1.8. Projekte në fushën e lavërtarisë dhe perimtarisë;
 - 1.9. Projekte në fushën e blegtorisë dhe bletarisë;
 - 1.10. Projekte në fushën e bimëve mjekësorë;
 - 1.11. Pagesa direkt për sipërfaqet e mbjella me drithëra;
 - 1.12. Pagesa direkt për lopë, dele dhe dhi qumështore;
 - 1.13. Pagesa direkt për bletë dhe akuakulturë;
 - 1.14. Pagesa direkt për qumësht/litër sipas kategorive dhe cilësisë.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe grandeve duke përfshirë por pa u kufizuar, grandet me ngritje të serave, furnizim me mekanizëm bujqësisë, projekte të ndryshme në fushën e blegtorisë, bletarisë, pemëtarisë, perimtarisë, lavërtarisë, bimëve mjekësore, dhe fusha tjera të ngjashme, drejtoria obligohet që pas lejit nga kryetari i Komunës për lejimin e mjeteve dhe inicimin e thirrjes publike, të inicioj procedurat e Prokurimit në përputhje me projektin/vlerën që do të realizoj për blerjen e pajisjeve, mekanizmit, serrave, materialit fidanor dhe imputeve tjera bujqësore, për fermer.
3. Gjatë ndarjes së subvencioneve, transfereve dhe grandeve për bujqësi dhe zhvillim rural, në kushte të barabarta Komuna u jep përparësi:
- 3.1. Zonave me prioritet të identifikuar nga Komuna;
 - 3.2. Grave, të rinjve dhe të rejave, personave me nevoja të veçanta dhe status të veçantë;
 - 3.3. Aplikantëve që nuk kanë fituar më parë subvencione, transfere dhe grante nga Komuna gjatë vitit të njëjtë fiskal, dhe nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për bujqësi të ndarë nga pushteti qendror, apo nga ndonjë donator tjetër, me përjashtim të pagesave direkt.

Neni 22

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione, transfere dhe grande në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural me thirrje publike

1. Kushtet, kriteret dhe dokumentet për të qenë përfitues i subvencioneve, transfereve dhe grandeve duke u bazuar në kriteret e thirrjes publike, përfshijnë por pa u kufizuar si në vijim:
- 1.1. Formulari i aplikimit;
 - 1.2. Numri identifikues i fermerit (NIF);
 - 1.3. Certifikatën e biznesit (nëse funksionon si biznes dhe nëse kërkohet);
 - 1.4. Dokument valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
 - 1.5. Certifikata e pronës;
 - 1.6. Projektin dhe planin financiar (nëse kërkohet);
 - 1.7. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
 - 1.8. Konfirmimin nga banka me numrin e xhirollogarisë së aplikuesit;
 - 1.9. Vërtetim tatimor nga ATK (nëse kërkohet);
 - 1.10. Deklaratë se nuk është përfitues i granitit të ndarë nga pushteti qendror apo lokal në këtë fushë brenda viti fiskal, përjashtimisht pagesat direkt.

2. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni vlerësueses.

Neni 23

Kushtet, kriteret dhe dokumentet e nevojshme që duhet plotësuar për subvencione dhe transfere në pagesa direkt për sipërfaqe të mbjella me drithëra

1. Kushtet, kriteret dhe dokumentet e nevojshme për aplikim për pagesa direkt për sipërfaqe të mbjella me drithëra janë, por pa u kufizuar:
 - 1.1. Dokumentin valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Numri identifikues i fermerit (NIF);
 - 1.3. Certifikatën e pronës;
 - 1.4. Dëshmi mbi pagesën e tatimit në pronë;
 - 1.5. Kontratën e qirasë (nëse është prona e marr me qira);
 - 1.6. Konfirmimin bankar me numrin e xhirollogarisë në emër të aplikuesit;
 - 1.7. Deklaratën nën betim për sipërfaqen dhe vendin e mbjellur me drithëra (nga noteri).
2. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni vlerësueses.

Neni 24

Kushtet, kriteret dhe dokumentet e nevojshme që duhet plotësuar për subvencione dhe transfere për pagesa direkt për qumësht/litër

1. Kushtet, kriteret dhe dokumentet e nevojshme për aplikim për pagesa direkt për qumësht/litër, janë por duke mos u kufizuar:
 - 1.1. Formulari i aplikimit;
 - 1.2. Numrin identifikues të fermerit (NIF);
 - 1.3. Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
 - 1.4. Konfirmimi bankar me numrin e xhirollogarisë së aplikuesit;
 - 1.5. Kopja e listës së verifikimit të kafshëve: gjedhet, dhentë dhe dhitë, të lëshuar nga sektori për identifikim dhe regjistrim në kuadër të AUV-së;
 - 1.6. Kopja e kontratës, e vërtetuar nga noteri, për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara ose në ndonjëra nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjëren qumështore të licencuar;
 - 1.7. Dëshmia për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose pikën grumbulluese të qumështit;
 - 1.8. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
 - 1.9. Të ofrojnë dëshmi të lëshuar nga laborator i AUV për cilësinë e qumështit të dorëzuar në ndonjëren nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjëren nga qumështoret e licencuara;
 - 1.10. Të kenë kontratë, të vërtetuar nga noteri për shitjen e qumështit në ndonjëren nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjëren nga qumështoret e licencuara;
 - 1.11. Të ofrojnë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur;

2. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni vlerësues.

Neni 25

Kushtet, kriteret dhe dokumentet e nevojshme që duhet plotësuar për subvencione dhe transfere për pagesa direkt për krerë, lopë, dele dhe dhi qumështore

1. Kushtet, kriteret dhe dokumentet e nevojshme për aplikim për pagesa direkt- për krerë lopë, dele dhe dhi qumështore, janë por duke mos u kufizuar:
 - 1.1. Formulari i aplikimit;
 - 1.2. Numrin identifikues të fermerit (NIF);
 - 1.3. Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
 - 1.4. Konfirmimi bankar me numrin e xhirollogarisë bankare të aplikuesit;
 - 1.5. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
 - 1.6. Regjistri i lëshuar nga praktikant veterinarë të kontraktura nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve në AUV, i cili duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur në të gjitha fletët/faqet.
2. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni vlerësues.

Neni 26

Kushtet, kriteret dhe dokumentet e nevojshme që duhet plotësuar për subvencione dhe transfere për pagesa direkt për shoqëri bletësh dhe akuakulturë

1. Kushtet, kriteret dhe dokumentet e nevojshme për aplikim për pagesa direkt për shoqëri bletësh janë, por duke mos u kufizuar:
 - 1.1. Formulari i aplikimit;
 - 1.2. Numrin identifikues të fermerit (NIF);
 - 1.3. Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
 - 1.4. Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
 - 1.5. Dëshmi individuale nga ana e vet fermerit për numrin e shoqërive të bletëve dhe vendndodhjen e shoqërive të bletëve, e cila duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga Drejtoria Komunale përkatëse për Bujqësi – Komuna;
 - 1.6. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
 - 1.7. Në momentin e kontrollit të fermerit/aplikuesit, në rast se i mungon numri identifikues i fermës (NIF) në koshere, atëherë përjashtohet nga subvencionimi secila koshere pa numrin identifikues të fermës (NIF) të shënuar.
2. Kushtet, kriteret dhe dokumentet e nevojshme për aplikim për pagesa direkt për Akuakulturë janë, por duke mos u kufizuar:
 - 2.1. Formulari i aplikimit;
 - 2.2. Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës;
 - 2.3. Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
 - 2.4. Numrin identifikues të fermerit (NIF);

- 2.5. Certifikata veterinare- shëndetësore e lëshuar nga praktikat veterinare të licencuara nga AUV;
- 2.6. Dëshmi për sasinë dhe vendin e origjinës së ushqimit për peshk; me shumë se 500 kg. peshk të freskët (peshk i gjallë, i pastruar refuz, i mbytur dhe i ftohur në tem. +5° C i paketuar në vakum) për 6 muaj;
 - 2.6.1. Llojet e pranueshme të peshkut janë: trofta dhe krap;
 - 2.6.2. Të jenë të licencuar nga MBPZHR për zhvillimin e aktiviteteve në akuakulturë;
 - 2.6.3. Të jenë të regjistruar në AUV;
 - 2.6.4. Dëshmi nga ATK, për sasinë e shitur të peshkut të freskët (peshku i gjallë, peshku i pastruar refuz, peshku i mbytur dhe i ftohur në temp +5° C i paketuar në vakum);
 - 2.6.5. Përfituesi duhet të jetë banorë i Komunës së Prizrenit.
- 3 Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga Komisioni vlerësues.

Neni 27

SUBVENCIONET DHE TRANSFERET NË FUSHËN E SHËNDETËSISË

- 1 Kryetari i Komunës me kërkesën e drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi, emëron Komisionin me mandat 1 vjeçar, i cili bën shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga personat fizik që aplikojnë për subvencione dhe transfere në fushën e shëndetësisë, i cili përbëhet nga 3 anëtarë + 1 anëtar rezervë, ku të paktën njëri nga anëtarët duhet të jetë mjek specialist.
- 2 Komuna ndan subvencione dhe transfere për qytetarët të cilët janë banor rezident të Komunës së Prizrenit, për përballimin e shpenzimeve të shërimit, sipas kritereve të përcaktuara nga Drejtoria për Shëndetësi në shumën financiare deri në 5,000.00€, për kategoritë e mëposhtme:
 - 2.1. Të sëmurët me sëmundje malinje (CA), mund të mbështeten çdo vit, në rast të ofrimit të dëshmisë që gjendja e tyre shëndetësore është në përcjellje të vazhdueshme dhe janë duke marrë terapi për mbajtjen nën kontroll të sëmundjes së tyre;
 - 2.2. Të sëmurët me tumore beninje të cilët kanë nevojë për trajtim dhe mbikëqyrje për mbajtje nën kontroll të sëmundjes, mund të mbështeten çdo vit, në rast se dëshmojnë me raportet përkatëse mjekësore se janë nën përcjellje të vazhdueshme të sëmundjes. Në këtë kategori hyjnë të sëmurët me tumore si:
 - 2.2.1. Tumoret inoperabile (të pa operueshme);
 - 2.2.2. Tumoret e trurit;
 - 2.2.3. Tumoret e pankreasit
 - 2.2.4. Tumoret e mëlçisë (përveç hemangiomave).

- 2.3. Të sëmurët me tumore të tjera beninje mbështeten vetëm 1 herë, përkatësisht në vitin e operimit;
- 2.4. Fëmijët deri në moshën 18 vjeç, mund të mbështeten çdo vit në rast se dëshmojnë me raportet përkatëse mjekësore se janë nën përcjellje të vazhdueshme të sëmundjes e të cilët janë të diagnostikuar me sëmundjet si:
- 2.4.1** Sëmundjet neuromuskulare;
 - 2.4.2** Sëmundjet metabolike;
 - 2.4.3** Diabeti insulinë vartës;
 - 2.4.4** Defektet e lindura dhe të fituara të zemrës;
- Fibrozat cistike.
- 2.5. Zyrtarët publik të Komunës së Prizrenit, të sëmurë me sëmundje të rënda, mund të mbështeten vetëm 1 herë, përkatësisht në vitin e operimit, për të mbuluar një pjesë për shpenzimet e operimit dhe trajtimit. Kjo shumë mund të jetë deri në 30% të shumës së operimit, por pa kaluar kufirin e përcaktuar sipas paragrafit 2 të nenit 27 të kësaj rregulloreje. Kjo kategori mund të mbështetet vetëm për këto sëmundje:
- 2.5.2. Sëmundjet malinje ;
 - 2.5.3. Intervenimi kirurgjik në zemër (të gjitha intervenimet përveç stentimit).
- 2.6. Të sëmurët me sëmundje të tjera të rënda, mund të mbështeten vetëm 1 herë, përkatësisht vitin e diagnostikimit, ose më së largu në rast të mosaplikimit në vitin e diagnostikimit, 3 vite pas vitit të diagnostikimit. Në këtë kategori mund të përfitojnë të sëmurët me sëmundjet si:
- 2.6.1. Cirozë e mëlçisë – shkalla 3 dhe 4;
 - 2.6.2. Kardiomiopati të dillatative (zemra e zgjeruar) – shkalla 3 dhe 4;
 - 2.6.3. Gjakderdhjet në tru (ICV);
 - 2.6.4. Sklerozë Multiple.
- 2.7. Ndarja e subvencioneve për shëndetin publik (sipas rrethanave të krijuara).

Neni 28

Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Secili qytetar që hyn në kategoritë e mësipërme, mund të parashtrojë kërkesë për subvencionim, duke bashkangjitur dokumentet e mëposhtme:
 - 1.1.** Kopja e letërnjoftimit ose një dokument tjetër i identifikimit valid i Republikës së Kosovës;
 - 1.2.** Ekstrakti i lindjes i vitit përkatës kur aplikohet;
 - 1.3.** Konfirmimi i xhirollogarisë bankare aktive (rrjedhëse) i personit që aplikon për mbështetje.

1.4. Dokumentacioni mjekësor përfshirë këtu:

1.4.1. Për të sëmurët me sëmundje malinje (CA) par.2.1 të nenit 27 duhet: fletlëshimi nga spitali, raporti histo-patologjik (i biopsisë), raporte nga terapitë e marra (kimioterapi, radioterapi), raporti i vitit përkatës të aplikimit që dëshmon përcjelljen e gjendjes dhe marrjen e terapisë, nga mjeku kompetent i fushës që e mbulon sëmundjen;

1.4.2. Për të sëmurët me tumore beninje sipas par.2.2 të nenit 27 duhet: fletlëshimi nga spitali, raporti histo-patologjik (i biopsisë), raporti i CT ose RM në rastet inoperabile, raporti i vitit përkatës të aplikimit që dëshmon përcjelljen e gjendjes dhe marrjen e terapisë, nga mjeku kompetent i fushës që e mbulon sëmundjen;

1.4.3. Për të sëmurët me tumore beninje sipas par.2.3 të nenit 27, duhet fletlëshimi nga spitali, raporti histo-patologjik (i biopsisë);

1.4.4. Për fëmijët e prekur me sëmundjet e përcaktuara sipas par.2.4 të nenit 27, duhet fletlëshimi apo dokumente të tjera të trajtimit nga spitali, raporti i vitit përkatës të aplikimit që dëshmon sëmundjen, nga mjeku kompetent i fushës që e mbulon sëmundjen;

1.4.5. Për zyrtarët publik të prekur me sëmundjet e përcaktuara në par.2.5 të nenit 27, duhet fletlëshimi apo dokumente të tjera të trajtimit nga spitali dhe dëshmi të shpenzimeve të operimit për sëmundjen e përcaktuar;

1.4.6. Për të sëmurët e prekur me sëmundjet e përcaktuara sipas par.2.6 të nenit 27, duhet fletlëshimi apo dokumente të tjera të trajtimit nga spitali dhe raportet nga mjeku përkatës. Për rastet të cilat nuk aplikojnë gjatë vitit të diagnostikimit duhet edhe raporti i vitit përkatës nga mjeku kompetent që dëshmon gjendjen dhe sëmundjen përkatëse;

1.4.7. Lidhur me kategoritë e përcaktuara sipas par.2.7 të nenit 27, duke u bazuar në gjendjen e krijuar, do të përcaktohen kategoritë dhe kriteret për mbështetje me një dokument të veçantë nga drejtoria ose kryetari.

2. Kërkesat të cilat nuk kompletohen, dhe në mungesë të dokumentacionit, të njëjtat do të refuzohen nga drejtori i Drejtorisë, pas pranimit të rekomandimit të Komisionit, ndërsa ato që aprovohen nga Komisioni, përmes drejtorit të Shëndetësisë përcillen tek kryetari për nxjerrjen e vendimit për mbështetje financiare.
3. Shuma maksimale e mbështetjes për secilën kategori, miratohet nga Kryetari çdo fillim viti sipas kërkesës së DKSH dhe mundësive buxhetore të Komunës, duke respektuar kufirin e përcaktuar sipas paragrafit 2 të nenit 27 të kësaj Rregulloreje.

Neni 29

SUBVENCIONET DHE TRANSFERET NË FUSHËN E MIRËQENIES SOCIALE

1 Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale ndan ndihmë financiare – subvencione dhe transfere nga buxheti i saj, për këto kategori, por pa u kufizuar:

- 1.1. Mbështetje financiare për nënat lehona;
- 1.2. Subvencionimi për raste të veçanta për familjet në gjendje të vështirësi sociale, me çrregullim në sjellje dhe me sëmundje mendore;
- 1.3. Subvencionimi i qirasë për familjet të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit, jetojnë me qira dhe në gjendje jo të mirë financiare si dhe për rastet sociale që janë shfrytëzues të skemave sociale;
- 1.4. Subvencione për rastet e fëmijëve të braktisur, fëmijëve pa kujdes prindëror, fëmijëve të keqtrajtuar, abuzuar dhe viktimat të çfarëdolloj dhune, abuzimi, trafikimi, keqtrajtim i fëmijëve, fëmijët që i nënshtrohen formave të rënda të punës dhe secilit fëmijë që është i cenuar, fëmija viktimë të përdorimit të substancave narkotike;
- 1.5. Subvencione për rastet e grave dhe vajzave viktimat të dhunës në familje dhe të shkurorëzuara;
- 1.6. Subvencione për rastet e grave dhe vajzave viktimat të trafikimit.

2. **Furnizim me lëndë djegëse, ndihma ushqimore dhe veshmbathje për:**

- 2.1. Invalidëve të luftës (UÇK-së) dhe familjet e dëshmorëve;
- 2.2. Personave me nevoja të veçanta;
- 2.3. Nënata vetushqyese;
- 2.4. Të moshuarit;
- 2.5. Të riatdhesuarve të cilët nuk kanë të zgjidhur çështjen e banimit dhe jetojnë me qira;
- 2.6. Fëmijët dhe të rriturit me nevojat e veçanta;
- 2.7. Familjet në nevojë në rast të vdekjes së ndonjë anëtarit të familjes;
- 2.8. Për familjet që janë shfrytëzues të asistencës sociale dhe ata të cilët nuk i plotësojnë kriteret por që janë në varfëri të skajshme dhe nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit, qirasë.

3. **Subvencionimi i projekteve në fushën e shërbimeve sociale, të cilat aplikojnë për financim për implementim të projekteve të tyre**

- 3.1. Shërbime alternative për mbrojtje të fëmijëve të braktisur rekrutimi i familjeve strehuese për ofrimin e shërbimeve për fëmijët në strehim familjar (të gjitha komuniteteve);
- 3.2. Shërbime të rehabilitimit, këshillim psikosocial dhe trajtimit të avancuar për personat me nevoja të veçanta, fëmijë dhe të rritur (të verbëritë, të shurdhër, tetraplegjike, paraplegjike, lehtësimi i qasjes në marrjen e të gjitha shërbimeve të nevojshme);
- 3.3. Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, rezidenciale, ditore, përmes aktiviteteve rekreative për pensionist dhe persona të moshuar pa kujdes familjarë;

- 3.4. Shërbime mbështetëse dhe këshilluese për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara mendore si dhe trajnimi i stafit për këto kategori në avancimin e dhënies së shërbimeve;
 - 3.5. Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe grave, viktimave të dhunës në familje, abuzimeve të ndryshme, trafikimi me qenie njerëzore, si dhe mbështetja e grave për pavarësimin e tyre (nënat vetushqyese);
 - 3.6. Fëmijët dhe të rinjtë, të cilët janë apo mund të jenë viktimë të bulëzimit;
 - 3.7. Aftësimi i personave me aftësi të kufizuara për treg të punës;
 - 3.8. Minoritetet etnike në përfshirje sociale;
 - 3.9. Përdoruesit e substancave psiko-aktive;
 - 3.10. Familjet në kushte të pafavorshme socio-ekonomike.
4. Gjatë ndarjes së subvencioneve dhe transfereve për kategoritë nga pika 2.1 deri në 2.8 të paragrafit 2 të nenit 29, Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale obligohet që pas marrjes së vendimit nga kryetari i Komunës për lejin e mjeteve financiare, të inicioj procedura të Prokurimit në përputhje me projektin/vlerën që do të realizoj.
5. Kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për përfitimin e subvencioneve dhe garantëve për kategoritë nga pika 3.1 deri në 3.10 të paragrafit 3 të nenit 29, caktohen me thirrje publike në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe Rregullores MF-nr-04/ 2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 30

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- (1) Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione dhe transfere (pa thirrje publike) përfshijnë por pa u kufizuar:
- a) Kërkesa e palës (në të gjitha rastet);
 - b) Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës (në të gjitha rastet);
 - c) Ekstrakti i lindjes (në të gjitha rastet);
 - d) Certifikata e deklaratës familjare (në të gjitha rastet);
 - e) Konfirmimi i bankës me numrin e xhirollogarisë bankare në emër të përfituesit apo familjarit të tij (në të gjitha rastet);
 - f) Certifikata e vendbanimit (në të gjitha rastet);
 - g) Dëshminë e gjendjes civile që konfirmon lidhjen familjare (në të gjitha rastet);
 - h) Dëshmia/kartoni i skemës së ndihmave sociale (për rastet në asistencë sociale);
 - i) Vendimi për fëmijët që janë shfrytëzues të pensionit invaliditet (për rastet kur aplikuesi i takon kësaj kategorie);
 - j) Certifikata martesore (për rastet sipas pikës 1.5 të paragrafit 1 të nenit 29);
 - k) Dëshmi/ certifikata e vdekjes së prindit (për rastet sipas pikës 1.6 të paragrafit 1 të nenit 29);
 - l) Të gjitha vërtetimet tjera valide të aplikativë të cilët janë të liruar nga çfarëdo lloj pagese.

Neni 31
SUBVENCIONET, TRANSFERET DHE GRANTET NË FUSHËN E BARAZIZ
GJINORE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

1. Drejtoria e Administratës përkatësisht zyrtari/a për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut bëjnë ndarje të subvencioneve, transfereve dhe granteve për individ dhe OJQ-të, që promovojnë, të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, në fushën e trajtimit të barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi, projekte që promovojnë barazinë gjinore, që nxisin vetëdijesimin e qytetarëve për rëndësinë e barazisë gjinore në çdo fushë, dhe fusha të tjera të ngjashme.
2. Kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për përfitimin e subvencioneve dhe granteve për kategoritë nga paragrafi 1 i nenit 31, caktohen me thirrje publike në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe Rregullores MF-nr-04/ 2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 32
SUBVENCIONET, TRANSFERET DHE GRANTET NË FUSHËN E KULTURËS,
RINISË DHE SPORTIT

1. Komuna mund të ndaj subvencione dhe transfere për kulturë, rini dhe sport duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, në këto fusha:

1.1 Kulturë:

- a) Manifestime: shënimi i datave historike, shënimi i festave kombëtare dhe ndërkombëtare, shënimi i datave tjera me rëndësi për Komunën e Prizrenit;
- b) Mbështetje të aktiviteteve vjetore të OJQ-ve kulturore;
- c) Mbështetje teatrove amatore: prodhim të shfaqjes, pjesëmarrje e shfaqjes në nivel kombëtar;
- d) Shoqëri Kulturo-Artistike: mbështetje e aktiviteteve vjetore, pjesëmarrja në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare;
- e) Ekspozitat;
- f) Muzikë: kompozim i veprës së re, audio-incizim, koncert, fuqizimi i muzikantëve të rinj,
- g) Pjesëmarrje në festivale, konferenca dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare;
- h) Aktivitete me karaktere garuese;
- i) Organizimi i festivaleve tradicionale dhe të reja, trajnim, punëtori, debat, tryezë, ligjëratë simpozium dhe konferencë;
- j) Botimi dhe promovimi i librave;
- k) Blerja e veprave artistike.

1.2 Rini:

- a) Mbështetje të aktiviteteve vjetore të OJQ-ve rinore;

- b) Promovimi i vullnetarizmit;
- c) Integrimi i grupeve rinore dhe atyre të marginalizuara;
- d) Pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete tjera kombëtare dhe ndërkombëtare;
- e) Aktivitete me karaktere garuese;
- f) Organizime për shënimin e datave kombëtare dhe ndërkombëtare me karakter rinor;
- g) Vizita studimore;
- h) Organizimi i trajnimeve, punëtorive, debateve, tryezave, ligjëratave dhe konferencave;
- i) Shpërblime vjetore: vullnetari i vitit, ngjarja rinore e vitit dhe organizata rinore e vitit.

1.3 Sport:

- a) Masivizimi i sportit (masivizimi i sportit për të rinj, avancimi i aktiviteteve në klubet sportive të femrave, integrim i personave me aftësi të kufizuar në aktivitete dhe gara sportive;
 - b) Mbështetje: për klubet publike sportive përfshirë edhe aktivitetet vjetore, sportistët kulmorë, dhe pjesëmarrje në garat sportive ekipore dhe individuale me karaktere garuese;
 - c) Promovimi i talenteve të rinjë;
 - d) Organizimi i trajnimeve, punëtorive, debateve, tryezave, ligjëratave dhe konferencave;
 - e) Gazetarët sportiv;
 - f) Botimi dhe promovimi i librave dhe revistës vjetore sportive;
 - g) Pjesëmarrje në konferenca dhe aktivitete tjera kombëtare dhe ndërkombëtare;
 - h) Manifestime: shënimi i datave historike, shënimi i festave kombëtare dhe ndërkombëtare, shënimi i datave tjera me rëndësi për Komunën e Prizrenit;
 - i) Vizitat studimore për sportistë dhe trajnerë;
 - j) Shpërblime vjetore: sportistët/ laureatët e sportit, shpresa e sportit, ngjarja sportive e vitit, klubi sportiv i vitit dhe individët e inkuadruar në sport si punëtorë profesional (trajnerë, reverë, punëtorë sportivë, veteranë të sportit, gazetarë sportive, post mortum etj.).
2. Kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për përfitimin e subvencioneve dhe granteve për kategoritë nga pika 1.1 deri në 1.3 i paragrafi 1 të nenit 32 caktohen me thirrje publike në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe Rregullores MF-nr-04/ 2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 33

SUBVENCIONE DHE TRANSFERE NË SEKTORIN E MJEDISIT

- 1.** Komuna mund të ndaj subvencione dhe transfere në fushën e mjedisit duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, në këto fusha:

- 1.1.** Shënimi i festave mjedisore (java ekologjike, dita e tokës, dita e mjedisit etj.)

- 1.2. Edukimi mjedisor: fushata pastrimi, mbjellje, kuize, tribuna, anketime, për mjedis, konkurs mjedisor, fushatë mediale.
2. Kriteret dhe dokumentacioni i nevojshëm për përfitimin e subvencioneve dhe granteve, caktohen me thirrje publike në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe Rregullores MF-nr-04/ 2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 34

SUBVENCIONE DHE TRANSFERET NË FUSHEN E EMERGJENCAVE

1. Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri, bën shqyrtimin e kërkesave të parashtruara nga personat fizik dhe juridik që aplikojnë për subvencione dhe transfere në fushën e fatkeqësive nga zjarri dhe fatkeqësive natyrore dhe pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar i rekomandon kryetarit për vendimarrje.
2. Personat fizik mund të përfitojnë subvencione dhe transfere sipas nenit 34 të kësaj rregulloreje në vlerë maksimale deri në 3,000.00€, ndërsa për personat juridik deri 5,000.00€.

Neni 35

Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione dhe transfere (pa thirrje publike) në Drejtorinë për Emergjencë dhe Siguri përfshijnë, por pa u kufizuar:
 - 1.1. Kërkesa nga pala;
 - 1.2. Dokumenti valid i identifikimit i Republikës së Kosovës (për persona fizik dhe juridik);
 - 1.3. Certifikata e vendbanimit (për persona fizik dhe pronarin/përfaqësuesin e personit juridik);
 - 1.4. Certifikata e regjistrimit për persona juridik (nëse rasti ka të bëjë me person juridik);
 - 1.5. Konfirmimi i bankës me numrin e xhirologarisë bankare në emër të përfituesit;
 - 1.6. Dëshmitë me fotografi apo video incizim nga dëmet e shkaktuara nga zjarri apo nga fatkeqësitë natyrore;
 - 1.7. Vërtetimi nga Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri.

Neni 36

Monitorimi i përfituesve të subvencioneve, transfereve dhe granteve

1. Komuna/Njësia përkatëse që ka bërë ndarjen e subvencioneve, transfereve dhe granteve, bënë monitorimin e përfituesve të subvencioneve, transfereve dhe granteve, në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas Vendimit apo Marrëveshjes të mjeteve të ndara në formë të subvencioneve dhe granteve.

2. Procesi i monitorimit, periudha kohore e monitorimit dhe i veprimeve tjera me interes për njësinë kërkuese, duhet të përcaktohen në marrëveshjen e nënshkruar mes Komunës dhe përfituesit.
3. Komuna ka të drejtë të inicioj auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga komuna në formë të subvencioneve, transfereve dhe granteve.
4. Gjatë monitorimit të projektit, nëse konstatohet se përfituesit nuk i përmbahen programit të financuar dhe kushtet e përcaktuara të marrëveshjes së nënshkruar mes Komunës dhe përfituesit, atëherë ai/ajo do të procedohet sipas procedurave ndëshkimore të përcaktuar në kontratë apo ligjeve në fuqi që rregullojnë këtë fushë.

Neni 37

Raportet kthyes nga përfituesit e subvencioneve dhe granteve

1. Përfituesit e subvencioneve, transfereve dhe granteve të ndara nga Komuna obligohen që në njësinë përkatëse në të cilën kanë qenë përfitues të subvencioneve, transfereve dhe granteve, të dorëzojnë raport financiar dhe narrativ.
2. Përfituesit e subvencioneve, transfereve dhe granteve obligohen që pas marrjes së subvencionit apo grantit, të dorëzojnë në njësinë përkatëse raportin financiar me të gjitha shpenzimet financiare ashtu siç janë kërkuar me projekt-propozim. Raporti duhet t'i ketë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportet bankare, faturat e rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve, etj.).
3. Përfituesit e subvencioneve, transfereve dhe granteve obligohen që pas përfundimit të subvencioneve të dorëzojnë raportin narrativ i cili duhet t'i ketë të gjitha të dhënat e aktiviteteve që janë realizuar gjatë zbatimit të projektit.
4. Periudha kohore e raportimit duhet të përcaktohet në marrëveshjen e nënshkruar mes njësisë, Komunës dhe përfituesit.
5. Raportet nga paragrafi 1 (një) i këtij neni protokollohet dhe një kopje e tyre dorëzohet në arkivin e lëndës.

Neni 38

Transparenca në ndarjen e subvencioneve me thirrje publike

1. Komuna publikon listën preliminare dhe përfundimtare të përfituesve të subvencioneve dhe granteve.
2. Vendimi preliminar dhe përfundimtar i përfituesve duhet të përmbajë: emrin e përfituesit, fushën për të cilën jepet subvencioni.

3. Publikimi i vendimit së përfituesve nga ndarja e subvencioneve bëhet në ueb-faqen e Komunës ose në tabelat e shpalljeve të Komunës.

Neni 39
Dispozitat shfuqizuese

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet rregullorja nr. 01/011-9014 e datës 26 prill 2013 për Subvencione dhe Transfere dhe plotësim ndryshimi i saj, nr.01/011-82839 i datës 18 gusht 2020.

Neni 40
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore shpallet 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë Përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, dhe hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Prizrenit.

Kryesuesja e Kuvendit

Antigona Bytyqi